



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3668/19 prot.

Datë 03.03.2026

V E N D I M
Nr. 339/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 174/2026, datë 03.02.2026, i korigjuar, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-64321-10-09-2025, me objekt: “Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë- Pajisje elektronike”, me fond limit 25,561,492.97 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK, me NIPT K91803020F, dhe Rruga e Kavajes, pallati 207, shk.2, Tiranë.

Operatori ekonomik “PC Store” SHPK me NIPT L01606034A dhe adresë: Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK, me NIPT K91803020F, dhe Rruga e Kavajes, pallati 207, shk.2, Tiranë.

Operatori ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK me NIPT K62320012O, J61820021C dhe

adresë: Komuna e Parisit, Rruga Bilal Golemi, Nd.28, H.1.,
Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 02.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.174/2026 ku vendosi:
[...]

1. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK në procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-64321-10-09-2025, me objekt: “Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë- Pajisje elektronike”, me fond limit 25,561,492.97 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit*
3. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me bazën e kërkesës së autoritetit kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nr.484/1 prot., datë 06.02.2026, protokolluar me tonën me nr.3668/12 prot., datë 10.02.2026, me objekt “ *Sqarim në referim të dokumentacionit dhe nevojës për korrigjim të vendimit nr.174/2026 të KPP...*” ,

Komisioni i Prokurimit Publik në datën 13.02.2026 mori vendimin nr.259/2026 “Për korrigjimin e vendimit Nr.174/2026, datë 02.02.2026.

I.3 Me shkresën nr. 268/2 prot., datë 12.02.2026 protokolluar me tonën nr. 366816 prot., datë 27.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.174/2026 datë 02.02.2026, i korrigjuar për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-64321-10-09-2025, me objekt: “Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë- Pajisje elektronike”, me fond limit 25,561,492.97 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Shkresës së sipërpërmendur autoriteti kontraktor i ka bashkëngjitur procesverbalin e rivlerësimit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 268/2 prot., datë 12.02.2026 protokolluar me tonën nr. 366816 prot., datë 27.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.174/2026 datë 02.02.2026, i korrigjuar për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-64321-10-09-2025, me objekt: “Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë- Pajisje elektronike”, me fond limit 25,561,492.97 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Shkresës së sipërpërmendur autoriteti kontraktor i ka bashkëngjitur procesverbalin e rivlerësimit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.174/2026 datë 02.02.2026, i korrigjuar të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.174/2026 datë 02.02.2026, i korrigjuar të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-64321-10-09-2025, me

objekt: “Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë- Pajisje elektronike”, me fond limit 25,561,492.97 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

